

V E N D I M
Nr.527, datë 14.11.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.473, DATË
29.9.1993 "PËR TË DREJTAT E PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, PËR SHPENZIMET E UDHËTIMIT DHE TË
DIETËS PËR PERSONAT QË DALIN JASHTË SHTETIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I :

1. Në pikën 7, të pasqyrës që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.473, datë 29.9.1993, hiqen fjalët "konsull i përgjithshëm" dhe shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje "konsull i përgjithshëm 210".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta